



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. 3784 Prot

Shkodër, më 17.02.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim Relacioni dhe Projekt-Vendimi.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim Relacionin dhe Projekt-Vendimin:

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.54, DATË 30.09.2024 “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË BASHKISË SHKODËR DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË””

Duke Ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____._____.2026

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.54, DATË 30.09.2024 “PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR
OSE TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE
ADMINISTRATIVË TË BASHKISË SHKODËR DHE INSTITUCIONEVE TË
VARËSISË””**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____._____.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 51, nenit 54 shkronja “ç”, ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 ‘Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë’ të ndryshuar ; të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 ‘Për nëpunësin civil’ të ndryshuar; të ligjit nr.35/2023, datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike , si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar; të Vendimit nr.776, datë 19.12.2025 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; të Vendimit nr.103, datë 11.02.2026 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr.328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar”, të Vendimit nr. 87, datë 06.02.2026 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr.326 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike”, të ndryshuar” Vendimin nr.84, datë 18.12.2025 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar ; dhe sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër.

VENDOSI :

1. Ndryshimin e vendimit nr.54, datë 30.09.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve

administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, sipas tabelave bashkëlidhur.

2. Tabela nr.1 bashkëlidhur Vendimit nr.54, datë 30.09.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Tabela nr.2 bashkëlidhur Vendimit nr.54, datë 30.09.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij
4. Tabela nr.3 bashkëlidhur Vendimit nr.54, datë 30.09.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes dhe i fillojnë efektet financiare nga data 01 Janar 2026.



Zv. Kryetar

Alban Peko

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve
Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

G. Dume

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar

ELSON BRASHANI

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve Mbështetëse

Andote Perçaj

Drejtoria e Analizës dhe Programimit
Buxhetor

Drejtoria Juridike

V. Deepaj

Drejtoria e Financës

Alton Peko



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

RELACION

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.54, DATË 30.09.2024 “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË BASHKISË SHKODËR DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË””

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Shkodër për efekt të zbatimit të akteve ligjore të ndryshuara në lidhje me kufirin e pagave mujore të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, në lidhje me nivelet e pagave për të gjithë kategoritë e nëpunësve, punonjësve administrativë dhe në lidhje me pagën bazë për klasë për punonjësit mbështetës në Bashkinë Shkodër dhe institucionet e varësisë të saj, paraqet këtë relacion.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; ligjit nr.35/2023, datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike , si dhe të pages bazë minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar, Vendimit nr.776, datë 19.12.2025 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; të Vendimit nr.103, datë 11.02.2026 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr.328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar” dhe Vendimit nr. 87, datë 06.02.2026 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr.326 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike”, të ndryshuar”;

Bashkia Shkodër në kuadër të ndryshimeve të kufirit të pagave mujore të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nivelit të pagave për të gjithë kategoritë e nëpunësve, punonjësve administrativë dhe të pagës bazë për klasë për punonjësit mbështetës në Bashkinë Shkodër dhe institucionet e varësisë të saj, ka bashkëngjitur tabelat nr.1, nr.2 dhe nr.3 që zëvendësojnë tabelat me të njëjtin numër dhe titull bashkëlidhur Vendimit nr.54, datë 30.09.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar,

të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë” me ndryshimet si më poshtë:

- a- **Për funksionarët e zgjedhur, të emëruar, nëpunësit civilë, pagat për pozicion janë paraqitur**, duke filluar nga kategoria I-3, I-5, II-2, III- 2, III-3, IV-2, IV-3, IV-4, në katër nivele; nga niveli dysHEME deri tek niveli maksimal duke ruajtur të njëjtën përqindje rritjeje në të gjithë kategoritë, *referuar germës b) të lidhjes nr.1 dhe lidhjes nr.3 të Vendimit nr.103, datë 11.02.2026 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr.328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar”*.
- b- **Për punonjësit administrative, kufijtë e pagave bazë të punonjësve janë referuar pikës 11 të Vendimit nr.103, datë 11.02.2026 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr.328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar”**.
- c- **Për punonjësit mbështetës pagat bazë për klasë janë referuar;**
Lidhjes II të Vendimit nr. 87, datë 06.02.2026 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr.326 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike”, të ndryshuar”.
shkronjës b) ku citohet: “Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore miratojnë njësimin në page në përputhje me klasifikimin e funksioneve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për çdo funksion të ri që vendosin të krijojnë “**dhe d)** ku citohet: Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore miratojnë “pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë së tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të rasteve, kur me ligj të veçantë , është parashikuar ndryshe” të nenit 9 të ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", i ndryshuar,

pikës 9 ku citohet: “Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, kur shikohet e nevojshme të krijojnë funksione të reja të cilat nuk janë përcaktuar në lidhjet që

i bashkëlidhen këtij vendimi (VKM nr.328/2023, i ndryshuar), bëjnë njësimin e tyre, për efekt page, me klasifikimin e miratuar në lidhjet përkatëse të pagave të Vendimin nr.328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar.

pikës 10 ku citohet: *"Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore miratojnë pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë, me përjashtim të rasteve kur, me ligj, është parashikuar ndryshe, duke respektuar hierarkinë e pagave të nëpunësve apo punonjësve të bashkisë përkatëse" të Vendimin nr.328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar,*

shkronjës m) ku citohet: *"punonjësit mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme, që nuk parashikohen në shkronjat "a" deri në "ll", të kësaj pike (pika 12) në masën 4 000 katër mijë leke në muaj" të pikës 12 të Vendimit nr.326 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike", i ndryshuar me vendimin nr.422, datë 26.06.2024.*

Nga sa më sipër kërkojmë nga ana juaj miratimin e këtij projekt vendimi në zbatim të vendimeve të mësipërme .

Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, Ju ftoj ta votoni propozimin për miratimin e projekt vendimit.



Tabela nr.1 në leke

Niveli i pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar , të nëpunësve civilë dhe punonjësve administrative
(VKM nr.103, date 11.02.2026 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 328 dt. 31.05.2023" , i ndryshuar; neni 9/a, 9/b, 9/d i ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi" , i ndryshuar)

Funksionarë të zgjedhur										
Emërtimi	Vendndodhja	Kufiri i pagës mujore	Arsimi i lartë							
			Kategoria	Niveli i pagave						
KRYETAR	Bashkia Shkodër	297,250								
Sekretar i keshillit	Bashkia Shkodër		I-5	97,375	123,000	149,000	174,250			
Funksionarë të emëruar										
Emërtimi	Vendndodhja	Kufiri i pagës mujore			Arsimi i lartë					
		Kategoria	Niveli i pagave							
Zv/Kryetar	Bashkia Shkodër	230,625								
Drejtor kabineit	Bashkia Shkodër		I-5	97,375	123,000	149,000	174,250			
Keshilltar kryetari	Bashkia Shkodër		II-2	87,125	107,000	126,000	144,525			
Zëdhënës	Bashkia Shkodër		II-2	87,125	107,000	126,000	144,525			
Sekretar kryetari	Bashkia Shkodër		IV-4	41,000	51,000	58,000	65,000			
Administratorë										
Emërtimi	Vendndodhja	Kufiri i pagës mujore			Arsimi i lartë					
		Kategoria	Niveli i pagave							
Administrator me pak 5000 banorë	Njësi administrative Pult, Shosh, Shalë	66,625	93,000	118,000	143,500					
Administrator 5001-20000 banorë	Njësi Administrative Postribë, Guri Zi, Bërdicë, Velipojë, Dajç, Ana Malit	66,625	94,000	120,000	148,875					
Administrator 20001-50000 banorë	Njësi Administrative Rrethinat	82,000	108,000	134,000	158,875					
Administrator 20001-50000 banorë	Njësi administrative Lagje	82,000	108,000	134,000	158,875					
Nëpunës civil										
Emërtimi	Vendndodhja	Arsimi i lartë								
		Kategoria	Niveli i pagave							
Sekretar i Përgjithshëm	Bashkia Shkodër				I-3	102,500	139,000	175,000	210,125	

Drejtor i Përgjithshëm	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie						I-5	97,375	123,000	149,000	174,250
Drejtor Drejtorie	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie						II-2	87,125	107,000	126,000	144,525
Përgjegjës	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie						III-2	71,750	85,000	97,000	109,000
Përgjegjës	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie						III-3	66,625	79,000	91,000	102,000
Inspektor/Specialist	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie						IV-2	46,125	61,000	73,000	85,000
Specialist	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie						IV-3	43,050	56,000	66,000	75,000
Përgjegjës/specialist	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie						IV-4	41,000	51,000	58,000	65,000

Punonjës të emëruar

Emërtimi	Vendndodhja					Arsimi i lartë				
						Kategoria	Niveli i pagave			
Kryeinspektor	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					III-2	71,750	85,000	97,000	109,000
Kryeinspektor	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					III-3	66,625	79,000	91,000	102,000
Regjisor	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					III-2	71,750	85,000	97,000	109,000
Regjisor	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					III-3	66,625	79,000	91,000	102,000

Drejtues muzike	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					III-2	71,750	85,000	97,000	109,000
Drejtues muzike	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					III-3	66,625	79,000	91,000	102,000
Aktor	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					IV-2	46,125	61,000	73,000	85,000
Instrumentist	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					IV-2	46,125	61,000	73,000	85,000
Koreograf	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					IV-2	46,125	61,000	73,000	85,000
Klasifikatore	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					IV-2	46,125	61,000	73,000	85,000
Bibliotekare	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					IV-2	46,125	61,000	73,000	85,000
Historian	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					IV-2	46,125	61,000	73,000	85,000
Specialist muzeu	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					IV-2	46,125	61,000	73,000	85,000
Muzeolog	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					IV-2	46,125	61,000	73,000	85,000
Kujdestar	Bashkia Shkodër/ Institucion varësie					IV-2	46,125	61,000	73,000	85,000

Punonjës administrativë

(pika 11 e VKM nr. 103 dt.11.02.2026 "Për disa ndryshime në VKM nr.328 dt. 31.05.2023", i ndryshuar; neni 9/b, 9/d i ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", i ndryshuar, shkronja m) e pikës 12 të VKM nr. 326 dt. 31.05.2023", ndryshuar me VKM nr.422 dt. 26.06.2024)

Emërtimi	Vendndodhja	Arsimi i ulët/i mesëm						
		Klasa			Paga bazë		Shtesë për natyrë të veçantë pune	
Sekretar, arkivist, magazinier, operator, nepunes informacioni, roje, punonjes pastrimi, teknik i mirembajtjes, punonjes sekretarie, ndihmes specialist, ndihmes inspektor, shofer autoveture	Bashkia Shkodër					pika 11 (klasa VIII)	57000	4,000
Punonjës mbështetës								
(pika 9 dhe 10 e VKM nr. 328 dt. 31.05.2023", i ndryshuar; neni 9/b, 9/d i ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", i ndryshuar shkronja m) e pikës 12 të VKM nr. 326 dt. 31.05.2023", ndryshuar me VKM nr.422 dt. 26.06.2024 dhe me VKM nr.87 dt.06.02.2026)								
Emërtimi	Vendndodhja	Arsimi i ulët/i mesëm						
		Klasa	Paga bazë			Shtesë për natyrë të veçantë pune		
Punonjes sherbimi, sanitarë, pjatalaresë, probalaresë, roje, vrojtues, punonjës me kontratë, punëtor terreni	Bashkia Shkodër/ Institucione varesie	I		54,000				4,000
Ndihmëskuzhinier, Kaldast, Punonjës ngarkim shkarkimi, Garderobier, Punëtor skene.	Bashkia Shkodër/ Institucione varesie	II		55,000				4,000

Evidencier, Inventarizues, Rrobapëpës, Shofer autoveture, Shofer autonjetei transporti deri në 2.5 ton, Punëtorë të bazave prodhuese, roje, grimier, parukier, biletashitës, protokollist-	Bashkia Shkodër/ Institucione varesie					III	55,800			4,000
Operator, Magazinier, inspektor skene, rekuizitier, operator i ambjentëve sportive, shpërndarës ushqimesh, punonjës i mirëmbajtjes	Bashkia Shkodër/ Institucione varesie					IV	56,500			4,000
Teknik të mesëm të specialitëve të ndryshme, Kujdestar, Magazinier, Teknik ndërtimi, Infermier, Kuzhinier, Fotograf, Fotoreporter, inspektor sportiv, këngëtar i muzikës popullore, teknik i objekteve sportive	Bashkia Shkodër/ Institucione varesie					V	56,800			4,000
Punonjës sekretarie, piktor, disenjator, mjeshtër skene	Bashkia Shkodër/ Institucione varesie					VI	57,200			4,000

Sekretar shkolle në shkollat e arsimit bazë, Bibliotekar, Instruktor, Kujdestar në qendrat e përkujdesjes sociale, Shofer transporti me automjet mbi 2.5 ton, manovrator fadrome, punonjës menaxhimi qendrash komunitare	Bashkia Shkodër/ Institucione varesie						VII	57,600			4,000
Sekretar, Sekretar shkolle në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, Arkivist, Llogaritar/ekonomisti i mesëm, Shofer automjeti transporti mbi 2.5 ton dhe mjeteve speciale, Anketues, Topograf, Teknik i mesëm, teknik për mirëmbajtje ndërtesash.	Bashkia Shkodër/ Institucione varesie						VIII	58,100			4,000
Shofer me mjete speciale	Bashkia Shkodër/ Institucione varesie						IX	58,800			4,000
Manovrator i makinerive të rënda, Polic bashkiak, mekanik, motorist, elektrikist, tornitor, saldator, axhustator, llamarinist, ndriçues mixer, hidraulik, bojaxhi, marangoz, punëtor i kualifikuar, manovrator autoshkalle, manovrator fadrome	Bashkia Shkodër/ Institucione varesie						XIII	61,000			4,000

Shtesa për vjetërsi në punë e percaktuar në masën: i) 0,6%, pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vjet e para (1-10) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit, ii) 0,8%, pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vjet e dyta (11-20) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit, iii) 1%, pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vjet e treta (21-30) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, vjet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

Shtesa për vjetërsi në punë e percaktuar në masën 1 %, të pagës bazë për klasë, por jo më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shtese njihet vjetërsia e përgjithshme në punë. Përfashtohen nga kjo llogaritje vjetet të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vjet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

“Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët e drejtorive”, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit “Master i shkencave”/“Master profesional”/“Bachelor” apo të barasvlershëm me ta, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike”, “Inxhinieri informatike”, “Informatike”, “Inxhinieri telekomunikacioni” apo “Shkenca kompjuterike” “Teknologji informacioni”, “Informatikë ekonomike” dhe “Inxhinieri matematike informatike”. përfillojnë një shtesë mbi pagë, në masën: - 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK-ut, të bashkive me mbi 100 001 banorë.



Tabela nr. 2

ne leke

Masa e shpërblimit për anëtarët e Këshillit Bashkiak dhe kryetarët e fshatrave

(Neni 51 i ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe neni 9/c i ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", i ndryshuar)

Emërtimi	Masa e shpërblimit	Shpërblimi për person
Anetarë Këshilli Bashkiak	10 % e pagës së Kryetarit të Bashkisë	29,725
Kryetar fshati	10 % e pagës së Kryetarit të Bashkisë	29,725

KRYETAR



Tabela nr.3

ne leke

Niveli i pagave për punonjësit e "Policisë Bashkiake"

(Ligji nr.89/2022 "Për Policinë Bashkiake", VKM nr.103, datë 11.02.2026 "Per disa ndryshime ne vendimin nr. 328 dt. 31.05.2023" dhe neni 9/b, 9/d i ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", i ndryshuar, shkronja m) e pikës 12 të VKM nr. 326 dt. 31.05.2023", ndryshuar me VKM nr.422 dt. 26.06.2024 dhe me VKM nr.87 dt.06.02.2026)

Emërtimi	Vendndodhja	Arsimi i lartë				Arsimi i mesëm		
		Kategoria	Niveli i pagave			Klasa	Paga bazë	Shtesë për natyrë të veçantë pune
Drejtor Drejtorie	Bashkia Shkodër	II-2	87,125	107,000	126,000	144,525		
Përgjegjës	Bashkia Shkodër	III-2	71,750	85,000	97,000	109,000		
Inspektor / Specialist	Bashkia Shkodër	IV-2	46,125	61,000	73,000	85,000		
Specialist	Bashkia Shkodër	IV-3	43,050	56,000	66,000	75,000		
Punonjës sistemi me klasa								
Polic Bashkiak (trupë shërbimi)	Bashkia Shkodër						XIII	61,000
Shofer	Bashkia Shkodër						III	55,800
								4,000

Shtesa për vjetërsi në punë e përcaktuar në masën: i) 0.6%, pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1-10) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit, ii) 0.8%, pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11-20) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit, iii) 1%, pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21-30) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë e dokumentuar në librezhën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimi, shërbimi ushtarak të detyrueshëm, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

Shtesa për vjetërsi në punë e përcaktuar në masën 1 %, të pagës bazë për klasë, por jo më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shtese njihet vjetërsia e përgjithshme në punë. Përfshihen nga kjo llogaritje vitet të sigurimit vullnetar, vetëpunësimi, shërbimi ushtarak për meshkuj, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

